

REVISTA JURIDIKE SHQIPTARE

Masat e sigurimit në procesin penal:
Proporcionaliteti dhe standardet
europiane për kufizimin e lirisë

Av. Dorian MATLIJA



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PUBLIKUES

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)
Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3. (Dora D'Istria)
Tel: +355 44 104 247
E-mail: info@em-al.org
Web: www.em-al.org

AUTORË

Av. Dorian MATLIJA

VITI I PUBLIKIMIT

tetor 2025

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Revistës Juridike Shqiptare dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Hyrje	03
Kuadri normativ ndërkombëtar dhe ai vendas	04
Parimi i proporcionalitetit nga doktrina në praktikën që zhvillohet në sallën e gjyqit	05
Jurisprudenca europiane nga ishulli Asinara te protestat në Londër	06
Jurisprudenca shqiptare - Një pasqyrë kritike në dritën e Strasburgut	07
Masat alternative ndaj paraburgimit	08
Gjykatat shqiptare, vendi ku ndërpritet logjika e proporcionalitetit	09
Përfundime	11
BIBLIOGRAFIA	12

E drejta për liri dhe siguri personale është një gur themelor i rendit kushtetues demokratik. Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 27, e përkufizon qartë parimin “liria si rregull, kufizimi si përjashtim” dhe ia ngarkon gjykatave barrën për të kontrolluar çdo masë që mund të prekë fizikisht apo juridikisht lirinë e një individi. Në të njëjtën linjë, Neni 5 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), lejon privimin e lirisë vetëm në situata të kufizuara dhe të përshkruara qartë, me kusht që procedura të jetë “e përcaktuar me ligj” dhe pa arbitraritet.

Megjithatë, realiteti gjyqësor shqiptar ka treguar ndër vite se masat e sigurimit personal, sidomos paraburgimi, shpesh zbatohen mekanikisht. Praktikës së zakonshme të vendimeve “copy-paste” i mungon analiza individuale e proporcionalitetit, dhe testet ligjore zbatohen më shumë në formë se sa në përmbajtje. Sipas INSTAT, përqindja e personave të paraburgosur të padënuar luhartet në shifra mbi 50% çdo vit. Kjo praktikë përbën cenim të lirisë dhe krijimin e një kulture penale ku paraburgimi perceptohet si “normë e artë” dhe jo si zgjidhja extrema ratio, e justifikueshme vetëm kur masa të tjera rezultojnë të jenë realisht të pamjaftueshme për të arritur qëllimin.

Në këtë sfond, ky shkrim synon të përmbushë pesë qëllime kryesore:

1. Të përshkruajë shkurtimisht kuadrin ligjor ndërkombëtar (KEDNJ, udhëzimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)) dhe vendas (Kushtetuta, Kodi i Procedurës Penale) që rregullon privimin/kufizimin e lirisë.

2. Të analizojë ushtrimin e balancës së proporcionalitetit, duke shpjeguar nevojën për testim (legjitimiteti, nevoja, balanca) dhe nevojën e arsyetimit individual.

3. Të shqyrtojë jurisprudencën që përcakton kufirin midis kufizimit të lirisë dhe heqjes së lirisë.

4. Të krahasojë standardet europiane me praktikën shqiptare, duke analizuar në detaje rastet Gëllçi (2025), Delijorgji (2015), Hysa (2023) dhe Berisha (në komunikim), për të nxjerrë shkaqet e përsëritura të shkeljeve.

5. Të ngacmojë reflektime për masa, normative dhe praktike, që synojnë forcimin e garancive procedurale, promovimin e masave alternative dhe rritjen e cilësisë së arsyetimit gjyqësor.

Duke ndërthurur analizën teorike me shembuj praktikë, artikulli synon të kontribuojë në debatin akademik e profesional mbi kufijtë e pranueshëm të ndërhyrjes shtetërore në lirinë personale dhe të ofrojë udhëzime të zbatueshme për gjyqtarë, prokurorë e politikëbërës shqiptarë në përpjekjen për t'u përputhur me standardet europiane.

Kuadri normativ ndërkombëtar dhe ai vendas

Busulla kryesore për mbrojtjen e lirisë fizike është Neni 5 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Liria mund të cenohet vetëm në rrethana të caktuara, p.sh. pas një vendimi penal të formës së prerë, etj. Edhe kur shteti është përpara një rasti që plotëson kushtin, ai duhet t'i përmbahet rreptësisht procedurës “të përcaktuar me ligj” dhe të shmangë çdo shenjë arbitrariteti. Mosrespektimi i këtyre kufijve sjell pasoja dhe GJEDNJ ka përsëritur, sidomos në vendimet Medvedyev k. Francës (2010) dhe Buzadji k. Moldavisë (2016) se çdo ditë privim i pajustificuar kthehet në shkelje e sjell detyrimin për dëmshpërblim.

Korniza e Konventës plotësohet nga paragrafët 2-5 të të njëjtit nen, të cilët vendosin një regjim garancish. Personi i ndaluar duhet të informohet menjëherë për arsyet, të dalë pa vonesë para gjykatës, t'i jepet gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose përndryshe të lirohet, dhe në fund të ketë të drejtë kompensimi nëse heqja e lirisë shpallet e paligjshme.

Jurisprudenca e GJEDNJ ka bërë edhe dallimin midis “kufizimit të lirisë” dhe “heqjes së lirisë”, edhe në rrethana praktike që përfshihen në një “zonë gri” të interpretimit. Kjo bëhet përmes analizës së intensitetit. Rasti i famshëm Guzzardi kundër Italisë (1980) shënoi një pikë kthese, kur GJEDNJ konstatoi se izolimi për 16 muaj në një zonë ishulli prej 1.6 km², i shoqëruar me mbikëqyrje të vazhdueshme, tejkalonte kufizimin dhe përbënte heqje të vërtetë lirie.

Në Shqipëri, e njëjta filozofi përthithet në Nenin 27 të Kushtetutës, i cili pasqyron gati fjalë për fjalë qëndrimin e KEDNJ. Garancitë procedurale vijojnë me Nenin 28, ku sanksionohet se vetëm gjykata mund të vendosë masa sigurimi dhe se brenda 48 orësh personi duhet t'i paraqitet një gjyqtari. Sistemi ngurtësohet më tej në Kodin e Procedurës Penale (KPP), ku nenet 228-231 rendisin kriteret (ekzistenca e rrezikut real për arratisje, përsëritje e veprës penale ose pengim të drejtësisë) dhe parashikojnë një gradacion të qartë nga masat më pak kufizuese si “detyrimi për paraqitje”, “garancia pasurore”, “ndalimi i daljes jashtë shtetit”, deri te “arresti në shtëpi” e në fund “arresti në burg”. Legjislatori ka vendosur edhe kufij maksimalë kohorë, me kusht që çdo zgjatje të shoqërohet me motivim të posaçëm dhe të kontrollohet periodikisht nga gjykata.

Megjithëse ndryshimet e vitit 2017 e futën shprehimisht testin e proporcionalitetit dhe detyrimin për të shqyrtuar masat alternative, raportet e misioneve ndërkombëtare vazhdojnë të vërejnë se në praktikë gjykatat shqiptare shpesh mjaftohen me formula stereotipe si: “rrezik arratisjeje”, “rrezik ndikimi te provat”; pa i mbështetur ato me fakte konkrete. Mungesa e investimeve teknike e ka lënë pothuajse në letër edhe projektin për byzylykët elektronikë, të cilët do ta bënë arrestin shtëpiak një mjet realisht konkurrues ndaj paraburgimit.

Kështu, ndërsa korniza normative shqiptare duket teorikisht e harmonizuar me Konventën, hendeku midis ligjit dhe zbatimit mbetet i dukshëm. Pikërisht ky hendek bëhet objekt i analizës në vijim, ku ndërthuren standardet europiane me praktikat konkrete të gjykatave shqiptare.

Parimi i proporcionalitetit nga doktrina në praktikën që zhvillohet në sallën e gjyqit

Kur një gjyqtar vendos të kufizojë lirinë e dikujt, ai/ajo në teori duhet të përshkojë tre ndalesa të detyrueshme: të pyesë veten pse, sa duhet dhe a ia vlen. Këto tre pyetje formojnë testin klasik të proporcionalitetit: legjitimiteti i qëllimit, nevoja për të zgjedhur mjetin më pak kufizues dhe balanca ndërmjet dëmit që i shkaktohet individit dhe përfitimit publik që synohet. Ndërsa doktrina duket e thjeshtë në letër, praktikisht është pikërisht aty ku drejtësia jonë has pengesën më të madhe, sepse testi zbatohet shpesh me klishe, jo me fakte.

Interesi legjitim është hapi që zakonisht përmbushet pa shumë mund. Prokuroria pohon se masa synon të garantojë mbarëvajtjen e procesit, të parandalojë ndikimin mbi provat apo arratisjen. Problemi lind më pas. Në hapat e dytë e të tretë, te nevoja dhe balanca. Pikërisht këtu gjykatat shpesh rrëshqasin në fraza standarde si: “ekziston rreziku për arratisje”, “mund të ndikojë te provat”, apo “vepra penale është me rrezikshmëri të lartë”. Retorika mbetet e njëjtë, qoftë kur i pandehuri është përsëritës, ose mjek, apo zyrtar i lartë.

Në vështrimin e GJEDNJ kjo retorikë nuk kalon klasën. Në rastin historik Buzadji kundër Moldavisë(2016), Gjykata Europiane theksoi se, sapo kalon faza e parë e hetimeve, prokuroria duhet të sqarojë pse masat alternative si garancia pasurore, detyrimi i

paraqitjes, sekuestrimi i pasaportës, nuk mjaftojnë. Është një kërkesë e drejtpërdrejtë kjo që gjyqtari duhet të bazohet mbi fakte e jo në hamendje, se pse paraburgimi është i paevitueshëm.

Në Shqipëri, kjo logjikë u testua së fundmi në mënyrë të dhimbshme te rasti Gëllçi kundër Shqipërisë (2025). Gjykatat vendase këmbëngulën se ish-drejtori i RTSH-së mund të “ndikonte te provat”, edhe pse dosja e tenderit ishte sekuestruar prej kohësh e vetë i pandehuri ishte larguar nga detyra. GJEDNJ konstatoi se “rreziku” ishte thjesht një klishe sepse mungonin faktet që ta mbështesnin. Edhe në rastin Delijorgji k. Shqipërisë (2015) gjykata shqiptare u kufizua në konstatimin se “rrethanat nuk kishin ndryshuar”, duke harruar se ndryshimi kryesor duhej të ishte shtjellimi i ri i provave e jo përsëritja copy-paste e fjalëve “rrezik arratisjeje”.

Dimensioni i tretë, balancimi, kërkon guxim në gjykim. Kërkon të peshohet në njërën anë cenimi i lirisë, karrierës, familjes dhe, në anën tjetër, interesi që shteti mbron. Në rastin italian Guzzardi, Gjykata arriti në përfundimin se izolimi 16-mujor në një sipërfaqe të vogël, megjithëse nuk ishte qeli tradicionale, në fakt ia kishte marrë lirinë individit dhe prandaj, dëmi personal ishte shumëfish më i madh se interesi publik që synohej. Ky precedent është sot “lakmuesi” për çështje si Berisha kundër Shqipërisë (komunikuar), ku do të shihet nëse kufizimet mbi lëvizjen, të zgjatura në kohë, e kanë kaluar pragun dhe janë kthyer në heqje lirie.

Pra, proporcionaliteti nuk është një refren juridik, por një proces arsyetimi. Ajo çka GJEDNJ kërkon, dhe që ende mungon shpesh në Shqipëri, është që çdo vendim për prangosjen e individit, qoftë edhe “pranga shtëpie”, duhet të tregojë hapur se gjykata ka menduar realisht për alternativat, ka analizuar rrethana të veçanta të personit dhe, mbi të gjitha, ka marrë në konsideratë se a ia vlen kjo kosto mbi lirinë për përfitimin e drejtësisë? Vetëm kur përgjigjja del bindëse, masa është vërtet proporcionale.

Jurisprudenca europiane nga ishulli Asinara te protestat në Londër

Historia e mënyrës se si GJEDNJ dallon “kufizimin” nga “heqja” e lirisë nis, thajse si një rrëfim adventuresk, në brigjet shkëmbore të Sardenjës. Në nëntor 1980, Gjykata Europiane shpalli vendimin Guzzardi kundër Italisë. Zoti Guzzardi, një person nën “mbikëqyrje speciale”, ishte transferuar në Asinara, një ishull me sipërfaqe 1.6 km², dhe për më shumë se gjysmë viti jetoi me një regjim të rreptë: ndalim qarkullimi natën, detyrim t’i dorëzonte policisë itinerarin e ditës, paraqitje katër herë çdo 24 orë, madje edhe ndalim telefonatash pa leje. Italia pretendoi se nuk e kishte burgosur, por thjesht ia kishte “kufizuar lëvizjen”. GJEDNJ nuk u bind. E analizoi jetën e tij në Asinara si një mozaik faktorësh: hapësirën e vogël, kontrollin e vazhdueshëm, vetminë e detyruar, dhe tha fjalët që sot citohen në manuale që “ndryshimi midis kufizimit të lëvizjes dhe privimit të lirisë është çështje intensiteti, jo natyre”. Me atë frazë, GJEDNJ shpalosi parimin se forma

juridike e masës së sigurimit s’ka rëndësi. Nëse, de facto, kushtet krijojnë izolim, kemi heqje lirie.

Pas Guzzardit, Gjykata vijoi t’i nuhasë rastet me të njëjtin detektor intensiteti. Në Londrën e vitit 2001, policia rrethoi disa mijëra protestues në Oxford Circus për shtatë orë, një taktikë kjo që u pagëzua kettling. Kur çështja *Austin v. Mbretëria e Bashkuar* (2012) mbërriti në Strasburg, Gjykata pranoi se masa ishte drastike, por vuri në peshore kohëzgjatjen relativisht të shkurtër dhe rrezikun e menjëhershëm të përplasjeve. Konkluzioni ishte se kufizimi nuk e kishte kaluar pragun e “heqjes” së lirisë. Kështu, Guzzardi nuk u absolutizua, sepse intensiteti matet jo vetëm në kilometra katrorë, por edhe në orë e minuta.

Një vit më pas, në Bavarinë e futbollit të zjarhtë, tifozit Ostendorf iu vunë prangat për katër orë, që të mos niste sherr me ultrasit kundërshtarë. Në *Ostendorf v. Gjermani* (2013), GJEDNJ e justifikoi arrestin si proporcional pikërisht sepse ishte i shkurtër, i qartë në qëllim dhe i bazuar në rrezik të prekshëm.

Por sfilata e rasteve nuk përfundon aty. Në Moldavi, në çështjen *Buzadji*, paraburgimi zgjati më shumë se dy vjet. Gjykata e shfrytëzoi rastin për të vulosur një rregull të ri. Pas fazës së parë të hetimit, shteti duhet të dëshmojë me kujdes të veçantë pse masat alternative nuk mjaftojnë. Mungesa e arsyetimit të rifreskuar bëhet vetvetiu shkelje. Ky standard u rikonfirmua në vitin 2020, në rastin e opozitarit turk *Selahattin Demirtaş*. Gjykata theksoi se “dyshimi i arsyeshem” nuk mund të ndërtohet mbi retorikë politike, por kërkohen fakte

specifike, prova të gjalla, përndryshe paraburgimi kthehet në arbitraritet të pastër.

Kështu, nga ishulli i Asinarës deri te protestat londineze, e nga qelitë e Kishinaut në sallat e gjyqit të Ankarasë, Gjykata Europiane vazhdon të përdorë lupën e intensitetit dhe logjikën e proporcionalitetit për të dalluar kufizimin nga heqja e lirisë. Çdo shtet që tenton të luajë me formën, por në thelb ta mbajë individin në gjendje izolimi të zgjatur, e gjen veten përballë pasqyrës së Guzzardit: “Sa të izolovala? Sa gjatë? Me çfarë provash?” dhe, nëse përgjigjet nuk bindin, vendimi është i pritshëm që do të jete një shkelje e Nenit 5.

Jurisprudenca shqiptare - Një pasqyrë kritike në dritën e Strasburgut

Rasti Gëllçi (2025).

Historia fillon në vitin 2021, kur ish-drejtori i RTSH-së, Thoma Gëllçi, u vendos në paraburgim mes bujës mediatike për një tender të pajisjeve televizive. Të gjitha dokumentet kryesore ishin sekuestruar që ditën e parë të hetimit, kurse vetë Gëllçi u dorëzua vullnetarisht pasi ishte kthyer nga Shtetet e Bashkuara. Megjithatë, gjykatat shqiptare autorizuan, dhe më pas zgjatën, një paraburgim shtatë mujor duke përsëritur pa ndryshim formulën: “ekziston rrezik për dëmtim provash dhe arratisje”. Në Strasburg, kjo u quajt praktikë “copy-paste”. Gjykata Europiane vuri gishtin te paradoksi: nëse provat janë te prokuroria dhe i pandehuri ka ardhur vetë, ku fshihet rreziku? Për pasojë, u konstatua shkelje e Nenit 5, paragrafi 3.

Rasti Delijorgji (2015).

Fabula ishte ndryshe, por morali i njëjtë. Ndaj biznesmenit Mihal Delijorgji paraburgimi u shty përtej afateve ligjore ndërsa hetimet zgjatëshin. Në çdo shqyrtim periodik, gjykata thoshte vetëm kaq: “vijoje shkaqet e mëparshme”. Strasburgu i cilësoi shkelje të Nenit 5 § 1 (c), sepse privimi i lirisë u bë arbitrar dhe “jashtë çdo procedure të përcaktuar me ligj”. Për më tepër, kërkesat e Delijorgjit për lirimin u shqyrtuan me vonesa të pajustificuara e pa analizë substanciale, çka i mohoi atij të drejtën për kontroll të shpejtë e efektiv të ligjshmërisë së ndalimit, duke sjellë një shkelje të veçantë të Neni 5 § 4. Porosia e GJEDNJ ishte që forma, afatet, motivimi i ri, verifikimi periodik, nuk janë thjesht një luks formal, por një barrierë kundër arbitraritetit. Kur barrierë çahet, shkelja është e pashmangshme.

Rasti Hysa (2023).

Në këtë episod, një shtetase e akuzuar për mashtrim kërkoi garanci pasurore në vend të paraburgimit. Gjykata e Tiranës ia refuzoi me arsyetimin se “masa alternative nuk është e mjaftueshme për rrezikshmërinë e veprës”. Strasburgu i kujtoi autoriteteve vendase standardin që gjykata duhet të peshojë realisht çdo alternativë. Në mungesë të peshës faktike, të ardhurat, lidhja familjare, sjellja bashkëpunuese, përgjigjja “jo” nuk është vendim, por paragraf i zbrazët. Edhe në këtë rast u konstatua përsëri shkelje, sepse Nenit 5 i duhen arsye, jo etiketa boshe.

Rasti Berisha (komunikuar, 2024)

Rasti i katërt ende pritet të marrë verdiktin e Strasburgut, por është “lakmuesi” për zgjerimin e testit Guzzardi në Shqipëri. Sipas aplikantit, ai është izoluar në një zonë kontrolli të pandryshueshme, me paraqitje të shpeshta në polici, për rreth 18 muaj. Argumenti kryesor që merr vëmendjen e Gjykatës është që kur kontrolli fizik dhe kufizimi hapësinor zgjasin aq shumë, masa shndërrohet nga kufizim në heqje lirie, si në rastin e ishullit Asinara. Çështja do të tregojë sa janë të gatshme gjykatat shqiptare të analizojnë intensitetin kumulativ (kohë + hapësirë + survejim) dhe të pranojnë se, ndonjëherë, “masa alternative” mund të shndërrohet heshturazi në një burg.

Të gjitha këto histori lidhen me njëra-tjetrën tearsyetimet rutinë, zgjatjet mekanike të paraburgimit, mungesa e testit të alternativave dhe e analizës së intensitetit. Strasburgu u përgjigjet mbi faktin konkret dhe kontrollin periodik real. Sa më shpejt ta përthithin këtë standard gjykatat shqiptare, aq më pak do të shkojnë çështjet drejt Strasburgut dhe aq më tepër drejtësia shqiptare do t'i ngjajë vizionit kushtetues për të cilin është projektuar.

Masat alternative ndaj paraburgimit

Legjislacioni shqiptar, madje që prej kodifikimit të vitit 1995, e ka parashikuar qartë se paraburgimi duhet të jetë “extrema ratio”, pra mjete i fundit. Megjithatë, dorë për dorë me traditën post-komuniste të “sigurisë me pranga”, masat alternative kanë ngecur në statusin e një dekorate ligjore: ekzistojnë në

tekst, por shpesh mungojnë në praktikë. Ja ku ndodhet seicila nga tre alternativat kryesore sot:

Garancia pasurore, një mjet që luhetet ndërmjet qindarkës dhe milionit

Logjika e garancisë është e thjeshtë. Vendos një shumë të arsyeshme, mjaftueshëm të lartë që personi të mos i prishë punë drejtësisë, por jo aq të lartë sa të mos mund ta paguajë. Në realitet ndodhin dy skenarë ekstremë:

- Shuma simbolike, shpesh nën 500 000 lekë. Për individët me të ardhura të larta, kjo është pak a shumë sa një gjobë dhe efekti frenues zbehet.
- Shuma marramendëse, të materializuara në disa milionë lekë që, për shumicën, janë të paarrtshme. Në vend që të zëvendësojë paraburgimin, masa bëhet de facto e pamundur.

Këtu mungojnë udhëzime mbi kriteret. Mungon përshkallëzimi i garancisë lidhur me të ardhurat, pasurinë reale, rrezikun e arratisjes, por edhe mundësitë për t'i konfiskuar lehtë fondet në rast shkeljeje. Pa një guidë të tillë, gjyqtarët do të vazhdojnë të manovrojnë mes dy skajeve, e garancia nuk e luan asnjëherë rolin e saj të vërtetë.

Detyrimi i paraqitjes, instrumenti që me zor po pret epokën dixhitale

Në parim, detyrimi i paraqitjes është një zgjidhje elegante sepse mban kontakt sistematik me të pandehurin, siguron

bashkëpunim dhe, ndërkohë, i lë atij ritmin e përditshëm të jetës. Por mbajtja e dosjeve në letër e ka kthyer në një stërmundim administrativ. Oficeri i policisë gjyqësore shënon me dorë procesverbalet e takimeve dhe gjykata verifikon letrat. Aq më tepër, çdo mungesë e justifikuar (p.sh. paaftësi për arsye shëndetësore) mbetet peng i dërgimit të letrës nga avokati.

Reformimmi i kësaj alternative kërkon një skemë raportimi dixhital në kohët e sotme kur mundësitë janë. Për shembull mund të përdoren aplikacione me GPS që dërgojnë automatikisht sinjal tek serveri i policisë në kohën e caktuar dhe sinjalizojnë nëse personi nuk ndodhet në rrezen e lejuar, si dhe gjenerojnë raporte për prokurorin pa humbje kohe. Disa shtete e kanë implementuar tashmë dhe kostoja është e përbalueshme.

Arresti shtëpiak dhe byzylyku elektronik

Arresti në shtëpi, sidomos kur kombinohet me monitorim elektronik, është gjetja ideale për rastet ku gjykata dyshon në rrezik serioz arratisjeje, por jo në rrezik të shkaktimit të veprave të dhunshme. Shqipëria ka miratuar konceptin në Kod, madje Ministria e Drejtësisë ka pilotuar projekte për byzylykun GPS. Por pajisjet janë të pakta, stafi teknik i papërgatitur dhe fondet burokratike ende të bllokuara.

Nevojitet një buxhet vjetor i dedikuar për blerjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, shumë më të lira se kostoja ditore e një të paraburgosuri. Nevojitet një manual operativ për policinë dhe prokurorinë, si dhe një fushatë trajnimesh për gjyqtarë dhe avokatë që masa të shihet si opsion serioz.

Gjykatat shqiptare, vendi ku ndërpritet logjika e proporcionalitetit

Po të shfletojë dikush dosjet e paraburgimit në një gjykatë shqiptare, gjen shpesh të njëjtën skemë. Aty gjen një faqe e gjysmë tekst, ku renditen fjalët e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale dhe fjalitë klishe: “rrezik arratisjeje”, “rrezik për prishje provash”, “rrezik përsëritjeje të veprës”. Kaq mjafton që dera e qelisë të të mbyllet. Statistikat e bëjnë dukurinë të prekshme. Shkurt, kultura e “standardeve formale” gëlon. Ligji citohet, por nuk analizohet. Proporcioni përmendet, por nuk peshohet.

Kjo shpjegon pse çështjet Gëllçi, Delijorgji, Hysa e Berisha përfundojnë në Strasburg. Gjykatat tona flasin në stereotip, ndërsa GJEDNJ kërkon anatomitë e rastit. Zgjidhja nuk vjen me ligj të ri, sepse Kodi tashmë i ka normat, por me udhëzimin praktik që të shndërrojë doktrinën në ritual të përditshëm. KLGJ-ja mund ta bëjë këtë me një qarkore të thjeshtë, një check-list prej disa hapash, që çdo gjyqtar ta mbajë mbi tryezë kur vendos masa sigurimi, si për shembull:

- Identifikimi i rrezikut – Të specifikohet qartë për çfarë po flitet? Për arratisje, për pengim provash apo për rrezik të individit sepse vepra penale për të cilën akuzohet është e rëndë? Jo “të treja bashkë” sa për të qenë brenda, por vetëm për atë që mbështetet mbi fakte.
- Evidentimi i fakteve – Çfarë faktesh e ushqejnë rrezikun? Udhëtimet e shpeshta jashtë shtetit, likuiditete, ndikim konkret mbi dëshmitarët? Rreziku pa provë është hipotezë, jo arsye.

- Analiza e masave alternative – Gjyqtari të shpjegojë pse garancia pasurore, detyrimi për paraqitje, arresti në shtëpi nuk mjaftojnë. Nëse alternativa refuzohet, arsyeja duhet të jetë po aq e fortë sa për vetë paraburgimin.
- Vlerësimi i kohëzgjatjes – A mjaftojnë 10 ditë? 1 muaj? 3 muaj? Çdo ditë shtesë kërkon motivim shtesë. Gjyqtari duhet të tregojë se koha është e lidhur me nevojën hetimore dhe nuk është thjesht “afati standard”.
- Balancimi final – Në fund, gjyqtari vendos në peshore dëmin që masa i shkakton individit (në liri, familje dhe profesion) me përfitimin publik (sigurinë e procesit hetimor). Ky hap nuk kalon me klishe por kërkon argument të kuptueshëm.

Paraburgimi nuk është rregull, por përjashtimi. Kur shteti vendos t'ia heqë një njeriu lirinë para se ta ketë shpallur fajtor, ai duhet të kalojë nëpër një filtër të imët argumentesh, alternativash dhe kontrollesh periodike. Leksioni i Guzzardit, se kufizimi i lëvizjes, i shtrirë në kohë e në hapësirë dhe i zbukuruar me emra administrativë, mund të kthehet lehtësisht në burg de facto, tingëllon sot po aq i freskët për gjyqtarin shqiptar sa në vitin 1980 për kolegët italianë.

Vërtet, Shqipëria ka hedhur disa hapa. Kodi përmban një gamë të plotë masash alternative dhe gjykatat i përmendin në vendime. Por shifrat dhe rastet në Strasburg tregojnë se këto hapa ende nuk krijojnë gjendjen e duhur. Kultura e “standardeve formale”, ku arsyetimi futet në më pak se 500 fjalë dhe alternativa refuzohet me një fjali, vazhdon të dominojë.

Trajnimi i detyrueshëm i magistratëve nuk është një luks akademik, por një urë konkrete që lidh tekstin ligjor me realitetin e duhur të sallës së gjyqit. Zbatimi i duhur do të sjellë tre përfitime të menjëhershme:

1. Mbrojtje më thelbësore të lirisë, sepse çdo ditë e kursyer nga prapa hekurave për ata që nuk paraqesin rrezik real është fitore për të drejtën;
2. Transparencë dhe llogaridhënie, sepse statistikat publike dhe arsyetimet i bëjnë gjykatat të lexueshme, prokuroritë të përgjegjshme dhe avokatët më efektivë.
3. Besim publik, sepse kur qytetarët shohin se masa më e rëndë përdoret vetëm atëherë kur alternativa dështon me prova, ata e pranojnë më lehtë vendimin, edhe kur është i dhimbshëm.

E thënë ndryshe, kur sistemi e kthen parimin “liria është rregull” nga slogan në praktikë, fiton jo vetëm individi i sotëm, por edhe institucioni i së ardhmes. Vetëm atëherë gjykatat shqiptare do të mund të mbajnë kokën lart jo thjesht para Strasburgut, por para çdo qytetari që troket në dyert e drejtësisë me shpresën se do të gjendet i trajtuar me masën e duhur, jo me masa se “ashtu është zakoni”.

- Guzzardi k. Italisë, vendim 6 nëntor 1980.
- Buzadji k. Moldavisë [Dhoma e Madhe], vendim 5 korrik 2016.
- Medvedyev dhe të tjerët k. Francës [Dhoma e Madhe], vendim 29 mars 2010.
- Gëllçi v. Albania, vendim 25 shkurt 2025.
- Delijorgji v. Albania, vendim 28 prill 2015.
- Hysa v. Albania, vendim 21 shkurt 2023.
- Guide on Article 5 – Right to Liberty and Security, përditësim 2024.
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, nenet 228–245.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 27–28.